



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 304, Datë 25.11.2022

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERNI SOLAR” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, ME VENDNDODHJE NË ZONËN BILISHT,
QARKU KORÇË**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 13, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 25.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1993/2 prot., datë 23.11.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “ERNI SOLAR” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën Bilisht, Qarku Korçë”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 227, datë 06.09.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ERNI SOLAR” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25-vjeçar.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 07.09.2022 dhe 08.09.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 20.09.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresën nr. 1492/1 prot., datë 15.09.2022, ERE i njoftoi shoqërisë fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Po ashtu, me qëllim sqarimin e të dhënave mbi sipërfaqen totale të zonës së projektit apo ndonjë gabimi të mundshëm në referencat përkatëse të kësaj prone që do të shfrytëzojë shoqëria “ERNI SOLAR” sh.p.k. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e projektit të centralit fotovoltaik, ERE

planifikoi dhe një seancë dëgjimore në datën 26.09.2022, me shoqërinë “ERNI SOLAR” sh.p.k., shoqërinë “NTSP” sh.p.k., shoqërinë “RTS” sh.p.k., Bashkinë Devoll dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Njoftimi për këtë seancë u bë me shkresën nr. 1492/1 prot., datë 16.09.2022.

- Në e-mailin e datës 21.09.2022, protokolluar në ERE me nr. 1492/3 prot., datë 21.09.2022, shoqëria “ERNI SOLAR” sh.p.k., ka depozituar dokumentacion në kuadër të objektit të seancës, ndaj me qëllim shqyrtimin e këtij dokumentacioni, me shkresën e ERE-s nr. 1492/4 prot., u njoftuan palët e interesit për anulimin e seancës së planifikuar. Gjithashtu, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1492/5 prot., datë 22.09.2022 dhe nr. 1492/6 prot., datë 23.09.2022.
- Nga shqyrtimi i sa depozituar nga shoqëria në lidhje me dokumentet pronësore që do të shfrytëzohë shoqëria “ERNI SOLAR” sh.p.k. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e projektit të centralit fotovoltai, rezulton se ajo ka nënshkruar disa akt-marrëveshje të reja në datën 22.09.2022.
- Duke qenë se në kontratat përkatëse të nënshkruara me MIE-n referohen akt-marrëveshjet e mëparshme, përsa i përket dokumenteve pronësore të territorit ku do të zhvillohet projekti, e po ashtu duke qenë se me akt-marrëveshjet e reja sipërfaqja totale e disa prej subjekteve nënshkruese të akt-marrëveshjeve ndryshon nga ajo e referuar në kontratën me MIE-n, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 267, datë 14.10.2022, u vendos shtyrja e vendimmarrjes së bordit të ERE-s me 30 ditë pune, me qëllim që të vijojë komunikimi shkresor me MIE mbi këto ndryshime, apo zhvillimin e një seance të mundshme dëgjimore me palët. Gjithashtu, brenda këtij afati shoqëria duhet të depozitonte dhe dokumentacionin tjetër të munguar të këtij aplikimi.
- ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme me shkresën nr. 1492/8 prot., datë 02.11.2022.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1492/9 prot., datë 03.11.2022 dhe nr. 1492/11 prot., datë 10.11.2022, shoqëria ka depozituar të gjithë dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe lejet nga institucionet respektive. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë gjithë dokumentacionin e kërkuar.
- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin,

transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga Studimi i Fizibilitetit të centralit fotovoltaik 2 MW rezulton se jetëgjatësia e një paneli shkon 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “ERNI SOLAR” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën Bilisht, qarku Korçë, për një afat 25-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI